



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

11	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	22.01.2019, në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Arlinda Kurtaj, Udhëheqëse e Sektorit për punë administrative të KK-së, punë të përbashkëta dhe çështje teknike
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Ardita Idrizaj, Eliot Kukiqi dhe Ajshe Metaj.
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari Haki Rugova, Nënkryetari Agim Ademaj, Mujë Osmanaj, Hysni Maxharraj, Lulzim Blakaj, Demë Çeta, Jashar Blakaj, Enver Rugova, Besart Dreshaj, Isa Hoxhaj, Vjosa Hysenaj, Zekie Sutaj, Dukagjin Hoxhaj, Elfete Blakaj dhe Hysen Pelaj OSBE.
Rendi i ditës: 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katërt (tetor-dhjetor 2018); 3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2018; 4. Shqyrtimi i Raportit të punës së KK-së për vitin 2018; 5. Shpallja në diskutim publik e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe 6. Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.	
Diskutimet:	
Kryesuesi z.Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje, po fillojmë. Propozoj që rendit të ditës t'i shtohet edhe pika e gjashtë, shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Pyeti kush është që të miratohet rendi ditës me pikën e gjashtë dhe konstatoj se rendi i ditës miratohet një zërit, pa vërejtje.	

Vendimet:	
KPF njëzëri miraton rendin i ditës me propozimin e Kryesuesit duke shtuar edhe piken e gjashtë, Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 1.	
Diskutimet:	
Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyet nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rreth procesverbalit? Nuk kërkuar fjalën askush.	
Vendimet:	
Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.	
Personat përgjegjës për zbatim:	
Afati për zbatim:	
Shqyrtimi i pikës 2.	
Diskutimet:	
Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës, Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katërt (tetor-dhjetor 2018). Fjalën ja kaloj Nënkryetarit Agim Ademaj. Nënkryetari, përshëndeti të pranishmit dhe fjalën ja kaloj Drejtorit për Buxhet dhe Financa Hysni Maxharrit. Nëse ki diçka për të shtuar urdhëro drejtor apo ja kalon fjalën zyrtarit. Hysni Maxharri, përshëndeti të pranishmit, pasi që Zyrtari kryesor financiar e ka përgatitur materialin kërkoj edhe ta bëjë prezantimin. Osman Sadikaj, Zyrtar kryesor financiar përshëndeti të pranishmit dhe bëri prezantimin e Raportit financiar për tremujorin e katërt (tetor-dhjetor 2018). Kryesuesi, falënderon për prezantimin dhe fjalën ja kaloj se pari Ajshe Metaj pastaj Eliot Kukiqi. Ajshe Metaj, përshëndeti të pranishmit. Vërejtje ngase nuk e kemi marr materialin, gjithmonë arsyetimi së nuk ka kohë. Sikur të kishim edhe pjesën analitike do të bënim disa analiza. Eliot Kukiqi, përshëndeti të pranishmit dhe unë ka pyetje direkte për planin e të hyrave 93.000,00€ (nëntëdhjetë e tre mijë euro). Osman Sadikaj, keni të drejtë për material por unë dje e kam marr dhe nëse ish dërguar prapë dje kish qenë me vonesë andaj nuk e kam dergu. Do ju dërgohet për mbledhjen e KK-së. Sa i përket vlerës 97.000,00€ (nëntëdhjetë e shtatë mijë euro) e jo 93.000,00€ (nëntëdhjetë e tre mijë euro) që pyeti Elioti, është vlerë që realizohet nga qiraja e tokave bujqësore. Arsye është së janë duke u identifikuar pronat. Planifikimi nuk ka qenë adekuat, duhet të debatohet kjo edhe në KK. Kemi pasur planifikim të kopshti i fëmijëve dhe nuk ka arritë vlerën që është planifikuar. Kjo	

mbetet që të behët planifikimi si duhet sepse të hyrat nuk kanë qenë të realizuara si duhet.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Ardita Idrizaj.

Ardita Idrizaj, përshëndet të pranishmit dhe pyet për udhëtimin e fëmijëve si është i rregulluar, kujt i paguhet udhëtimi?

Osman Sadikaj, paguhet për fëmijët në arsim fillor, ku gjatësia e udhëtimit është mbi 4 km (katër kilometra).

Kryesuesi, pasi që diskutime tjera nuk ka, kalon në pikën tjetër.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime të tjera, KPF-ja vendosi: Raporti financiar për tremujorin e katërt (tetor-dhjetor 2018) i kalohet Kuvendit për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës, Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2018. Ky raport ka qenë edhe në dëgjim me qytetarë. Fjalën ja kaloj nënkryetarit.

Nënkryetari, ky raport përfshinë punën e drejtorive dhe të kryetarit. Ka qenë në dëgjim publik. Gjatë kësaj kohë janë përmirësuar dhe janë shtuar të dhënat.

Kryesuesi, fjalën ja kaloj Ajshe Metajt.

Ajshe Metaj, unë kam shkoqit disa pjesë që mua mu kanë dukur si ma të rëndësishme. Konkretisht jam ndal tek auditori i brendshëm, shërbimet e gjendjes civile dhe inspeksioni. Te auditimi a ka ndonjë plan që është bërë, a është evidentuar ndonjë parregullsi? Te funksionimi i zyrave të gjendjes civile janë shënuar pesë zyre, a janë duke funksionuar? A funksionon Zyra e vendit në Vrellë? E di së ka qenë një punëtor por tani a është përzgjedh dikush? A jeni në proces që të përzgjidhet dikush? Dhe të inspeksioni e kam analizuar mirë dhe mungon inspektori i sanitarisë. Ju jeni në dijeni së çfarë ndodhi kohëve të fundit me mishin në Pejë. Sa jemi të rrezikuar, ish dashtë të punohet në këtë drejtim. Pastaj të Zyra për barazi gjinorë, muaji i regjistrimit falas i fëmijëve është për tu përshëndet por muaji tetor, trafikimi i qenieve njerëzore duhet të ndalemi më shumë. Ju falënderoj dhe kisha dashtë të më përgjigjni në pyetjet që parashtrova.

Nënkryetari, të auditmit e kemi një punëtor duhet edhe një në mënyrë që të punohet edhe me shumë. Ka plan ka raport që është bërë dhe dorëzuar kryetarit, normal ka të meta dhe vërejtje. Të gjendja civile, janë pesë zyre të vendit. Në Vrellë ka vdekur punëtori dhe nuk është duke funksionuar, aty është edhe e-kiosku dhe qytetarët nuk janë mbetur keq. Besoj se duhet të plotësohet ai vend. Te inspeksioni, ne kemi bërë kërkesën por aty më shumë është problem përzirja e kompetencave. Ne nuk mund të shpallim konkurs pa marr miratimin nga ministria. Shkrese ju

kemi bërë por përgjigje nuk kemi marrë. Për ma gjerësisht ja kaloj fjalën Drejtorit të Inspeksionit Demë Çetës.

Demë Çeta, përshëndet të pranishmit. Punëtorin që e kemi pasur ka shkuar në pension dhe tani detyrat e tij po i kryen inspektori i tregut dhe i veterinarëve. I kemi dërguar kërkesat për këtë pozitë por nuk kemi përgjigje ende.

Ajshe Metaj, a kemi rrezik në komunën tonë, është pikë e ndjeshme? E kemi edhe doktorin këtu? Te mbulohet sa më shpejt ky vend i punës.

Kryesuesi, fjalën ja kaloj Zenel Shatrit.

Zenel Shatri, përshëndet të pranishmit. Të gjitha shërbimet e ushqimit janë në kompetencë të AVUK-ut. Në Pejë e di së nuk ka inspektor sanitar. Edhe ky se ka qenë ka qenë kontestues. Ngase të gjitha këto i ka në kompetencë AVUK.

Kryesuesi, kush është që të kaloj në KK për shqyrtim ky raport.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF - vendosi: Raporti i punës së Kryetarit për vitin 2018, i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
--	-------------------------------

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
--------------------------	------------------------------

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi i Raportit të punës së KK-së për vitin 2018. Këtë raport e keni pasur dhe fjalën ja kaloj Ajshe Metajt.

Ajshe Metaj, jemi dëshmitar të punës që është bërë në kuvend andaj vetëm desha me përshëndet. Kur është mirë nuk hezitoj edhe të jap lëvdata.

Kryesuesi, pasi nuk dëshiron dikush tjetër të marr fjalën. Kush është që ky të shkojë në KK.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF - vendosi: Raporti i punës së KK-së për vitin 2018, i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
--	-------------------------------

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
--------------------------	------------------------------

Shqyrtimi i pikës 5.

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Shpallja në diskutim publik e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK). Prezent kemi dhe personat përgjegjës për prezantimin e këtij draft

plani. Fjalën ja kaloj Kryetarit z.Haki Rugova.

Kryetari, përshëndeti të pranishmit dhe fjalën ja kaloj Rexhep Blakajt nga Drejtoria e Kadastër dhe Gjeodezi.

Rexhep Blakaj, përshëndeti të pranishmit. Jemi të obliguar që të nxjerrim Planin Zhvillimor Komunal dhe hartën zonale të Komunës së Istogut në bazë të ligjit dhe udhëzimit administrativ. Prezantimin e këtij plani do të bëjë Ilir Gjinolli dhe Ardita Byci Jakupi.

Ardita Byci Jakupi, prezantoi Draft-Planin Zhvillimor Komunal për Komunën e Istogut.

Kryesuesi, falënderon për prezantimin. Pyet nëse dikush ka ndonjë pyetje dhe theksoi së më këtë do merrem edhe në të ardhmen.

Nënkryetari, unë kam pyetje pasi që edhe javën e tjetër kemi dëgjim lidhur me autostradën, desha të dijë së a duhet të inkorporohet në këtë? Mua ma merr mendja së ish dashtë edhe ajo të përfshihet në këtë plan. Me datë 30 janar 2019 është dëgjimi dhe do ishte mirë të merrni pjesë sepse mendoj së duhet të inkorporohet në hartën zonale.

Ilir Gjinolli, po edhe ajo duhet të inkorporohet në hartën zonale dhe kish qenë mirë që të jemi së bashku në dëgjim.

Kryesuesi, pasi që nuk ka diskutime kush është që kjo pikë e rendit të ditës t'i kaloj KK-së për shqyrtim?

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime tjera, KPF njëzëri vendos: Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 6.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdon më pikën e fundit të rendit të ditës, Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. E kemi obligim që të shpallet në diskutim publik. Fjalën ja kaloj Hysni Maxharrit.

Hysni Maxharri, përshëndeti të pranishmit, lidhur me rregulloren vetëm desha të ju tregoj se më ngjyrë të kuqe janë të hijezuara ato që duhet të hiqen ndërsa me ngjyrë të verdhë duhet të shtohen.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Zenel Shatri.

Zenel Shatri, përshëndeti të pranishmit dhe kërkoj sqarim. Tarifat a mundemi t'i caktojmë ne apo janë të rregulluara nga lartë?

Kryesuesi, fjalën ja kaloj Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj, ne e kemi rregulloren e kaluar. Ne materialin fizik e kemi vetëm më ngjyrë të zezë. Kërkoj që të dërgohet materiali më ngjyra.

Kryesuesi, nëse nuk ka diskutim, a jeni t'i përcillet KK-së për shqyrtim dhe shpallje në diskutim publik kjo rregullore.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime tjera, KPF njëzëri vendos: i kalohet KK-së për shqyrtim dhe shpallje në diskutim publik Projekt-Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Kryesuesi, pasi që përfunduan pikat për këtë rend ditë, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhëne dhe shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj :

12:30